REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr./Br. 46/23
Datë/Datum 08.02.23
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr. 46/23

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej, Agon Ramadani Kryetar Vedat Poterqoi, anëtar, Kimete Gashi- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: (OE) "Krosa Traffic Signs" sh.p.k me seli Ferizaj, kundër Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtja e rrugëve dhe shesheve me shenja të trafikut lot 2 Shenjat vertikale të komunikacionit dhe lot 6- Vendosja e shenjave (tabelave) të emërtimit të rrugëve" me nr. të prokurimit sipas platformës elektronike 656-22-10035-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Ferizaj, më datën: 07.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet** pajtimi i palëve për ankesën 46/23 të datës 20.01.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtja e rrugëve dhe shesheve me shenja të trafikut lot 2 Shenjat vertikale të komunikacionit dhe lot 6- Vendosja e shenjave (tabelave) të emërtimit të rrugëve" me nr. të prokurimit sipas platformës elektronike 656-22-10035-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Ferizaj.

II. **Obligohet** Autoriteti Kontraktues që aktivitetin e lartpërmendur në pikën I te dispoyitivit, konform raportit të ekspertit shqyrtues me të cilin AK dhe OE ankues janë pajtuar, të anulojë njoftimin mbi vendimin e AK-së për dhënie të kontratës të këtij aktiviteti të prokurimit dhe lënda të kthehet në **rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se OE ankues "Krosa Traffic Signs" sh.p.k me seli Ferizaj, është pajtuar me raportin e ekspertit shqyrtues për ketë aktivitet të prokurimit dhe sipas raportit të ekspertit ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Me 06.01.2023, AK Komuna Ferizaj, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B58 Njoftimin mbi Vendimin e autoritetit kontraktues për dhënie të Kantatës për aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja e rrugëve dhe shesheve me shenja të trafikut lot 2 Shenjat vertikale të komunikacionit dhe lot 6- Vendosja e shenjave (tabelave) të emërtimit të rrugëve".
Me datën 11.01.2023 Operatori Ekonomik "Krosa Traffic Signs" sh.p.k me seli Ferizaj, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim për aktivitetin e prokurimit të cekur më lartë, ndërsa me datë 17.01.2023 AK Gjykata Komuna Ferizaj, ka nxjerr vendim dhe ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim OE ankues si të pa bazuar dhe ka vërtetuar njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, për aktivitetin e prokurimit të lartë shënuar.
Me datën 20.01.2023 Operatori ekonomik, "Krosa Traffic Signs" sh.p.k me seli Ferizaj, ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 46/23, kundër njoftimin mbi vendimin për anulim lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.
Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur e ndarë në 6 lote, lloji i kontratës: Shërbime vlera e parashikuar e total kontratës në njoftim për kontratë është: 510.000.00€.

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë në OSHP vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse po ashtu ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe e njëjta bije nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me ketë, me 27.01.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:
- ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar,

- Të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Përgjigje në pretendimet e OE Ankues"Krosa Traffic Signs" sh.p.k me seli Ferizaj

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, sqarojmë se parashtruesi i ankesës sipas Letrës Standarde B46 të datës 06.01.2023, Oferta e OE ankues është trajtuar si ofertë e pasuksesshme për lot II dhe lot VI.

Pala në ankesë e konteston vlerësimin e bërë nga komisioni i vlerësimit pasi që i njëjti ka rekomanduar për kontratë një OE të pa përgjegjshëm i cili nuk e përmbushë kriterin e paraparë në njoftim për kontratë dhe dosje të tenderit i cili ka qenë "Autorizim nga prodhuesi apo distributori i autorizuar, për shenjat horizontale (ngjyrën) dhe vertikale te komunikacionit (foleja reflektuese)"
Dëshmia e kërkuar dokumentare;
"Autorizimin origjinal ose kopje te motorizuar ne origjinal nga prodhuesi apo distributori i autorizuar, për shenjat horizontale (ngjyrën) dhe vertikale të komunikacionit (foleja reflektuese)"

AK- komuna Ferizaj, në vendimin e datës 17.01.2023 kur ka refuzuar Kërkesën për ri-shqyrtim të OE ankues e ka pohuar se OE i rekomanduar nuk ka dorëzuar autorizim, por i njëjti ka dorëzuar një kontratë me kompaninë që ka autorizim nga distributori.
Eksperti Shqyrtues sqaron se, bazuar në analizën e fakteve/ dëshmive të dokumentuara në platformën elektronike E-prokurimi, AK- respektivisht komisioni i vlerësimi të ofertave-ZPP, gjatë vlerësimit të ofertave ka vepruar në kundërshtim me nenet; 59 paragrafi 4 dhe nenin 60 të LPP-së, si dhe nenin 40 paragrafi 40.1 dhe 40.2 të rregullores me nr 001/2022 për Prokurim Publik, kur ka rekomanduar për nënshkrim të kontratës OE N.SH Liriu Sh.p.k për lotet II dhe VI për faktin se OE nuk e ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit, pasi që kontratat e dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë në aspektin formal nuk i plotëson kriteret në formën si është kërkuar, përkatësisht nuk i përgjigjet kërkesës së specifikuar për autorizim në pikën 9.2. të FDT-s , ku tekstualisht kërkohet që të ofrohet: "Autorizim nga prodhuesi apo distributori i autorizuar, për shenjat horizontale (ngjyrën) dhe vertikale te komunikacionit (foleja reflektuese)"
Më tej, Kontratat e dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë, janë kontrata për shitblerje të lidhura në mes të OE Agro Com group shpk- Ferizaj si shitës dhe LIRIU N.SH Therandë si blerës, kontrata është e lidhur për periudhën 04.01.2022 deri me dt. 31.12.2023, kontrata tjetër e lidhur ne mes Tehn Odidatka Doo Shtip furnizues N.SH LIRIU blerës e lidhur me dt. 11.05.2022.
Kontratat e dorëzuara me ofertë nga OE- i rekomanduar për kontratë, tregojnë obligimet kontraktuale në mes të palëve nënshkruese që rrjedhin nga kontratat por, nuk prodhojnë efekte juridike ndaj palëve të treta në këtë rast ndaj AK komuna Ferizaj. Autorizimi nënkupton se pala, bartë të drejtat të cilat i posedon vet tek pala të cilën e autorizon që të mund të veproj njësoj sikur të ishte prodhues ose distributor. Andaj, kontratat e dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë nuk mund të trajtohen si autorizim për shitjen e ngjyrave tek palët tjera për faktin se OE NSH.

LIRIU nuk ka prezantuar ndonjë autorizim nga Prodhuesi apo distributori i autorizuar se i njëjti mund të shesë produktet " ngjyrat" tek palët e treta si kompani e autorizuar. Mbi këtë fakt oferta e OE N.SH LIRIU është ofertë e papërgjegjshme për këtë aktivitet të prokurimit.
Prandaj, në përputhje me konstatimet e mësipërme vlerësojmë se pretendimi i palës në ankesë në këtë pikë është i bazuar.

Lidhur me pretendimin se AK- Komuna Ferizaj ka shkelur nenin 10 të LPP-së për shkak se nuk i ka dhënë qasje në dokumente publike por AK, është vonuar në kohen e dhënies së qasjes, pasi ne si OE kemi bërë kërkesë për qasje në dokumente publike me dt. 07.01.2023 ne ora 12:31 minuta kurse AK na ka lejuar qasje me dt. 10.01.2023.
Eksperti Shqyrtues sqaron se, bazuar në analizën e fakteve/ dëshmive, dita në të cilën OE ka bërë kërkesë për qasje ka qenë ditë e shtune (pushim) po ashtu edhe dita e Hënë me dt. 09.01.2022 ka qenë ditë pushimi për shkak të festës zyrtare Pashkët Ortodokse. Bazuar në kërkesë për qasje të datës 11.01.2023 vërehet se përfaqësuesi i OE ankues Alban Krosa kishte marrë pjesë në qasje të dokumenteve dhe po ashtu kishte marrë dëshmitë në kopje elektronike përmes USB dhe nuk kishte paraqitur asnjë vërejtje lidhur me pretendimin ankimor të bërë në ankesë. Prandaj, në përputhje me konstatimet e mësipërme vlerësojmë se pretendimi i palës në ankesë në këtë pikë është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin se OE nuk e përmbushë kriterin e dosjes pasi që ka bashkangjitur një kontratë e lidhur me dt. 01.02.2019 ne mes SIB-BKA ShPK (punëdhënës dhe NSH LIRIU Suharekë me titull Furnizimi dhe ekzekutimi i punimeve të sinjalizimit horizontal dhe vertikal ne shumë prej 66,870.52€
Eksperti Shqyrtues sqaron se, bazuar në analizën e fakteve/ dëshmive, OE i rekomanduar ka dorëzuar listën e kontratave të realizuar në vlerë totale prej 502,977.11€. Nga lista e projekteve të realizuara OE NSH Liriu ka prezantuar projektet si : Shenjëzimi horizontal dhe vertikal Ak-Komuna Suharekë, vlera e realizuar 6,340,00€ për të cilat ka ofruar dëshmi si kontrata, raporte të pranimit teknik dhe referenca; Furnizimi dhe punimi i sinjalizimit vertikal të portave në oborrin e QKUK Lot 1 vlera e kontratës 39,022.60€ dhe anex kontrata në vlerë prej 3,899.50€ për të cilat ka ofruar dëshmi si kontrata, raporte të pranimit teknik; Furnizimi me shenja për shënjezim horizontal dhe vertikal ne komunën e Malishevës vlera e kontratës 26,885.00; Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve në Komunën e Rahovecit kontratë publike kornizë vlera e realizuar e kontratës 99,141.00€ për të cilën ka dorëzuar raportin e pranimit teknik dhe projekte tjera te ngjashme. Me ç'rastë OE N.SH Liriu e ka përmbushur kërkesën e dosjes së tenderit e cila ka qenë Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, shërbime, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë), në vlere minimale prej - LLOT II 60,000.00 € -- LLOT VI 60,000.00.

Prandaj, në përputhje me konstatimet e mësipërme vlerësojmë se pretendimi i palës në ankesë në këtë pikë është i pa bazuar.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 27 janar 2023 me raportin e

ekspertizës.

1.Autoriteti kontraktues – Komuna Ferizaj, me datën 30 janar 2023 ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues të OSHP-së .

2.Operatori ekonomik ankues "Krosa Traffic Signs" sh.p.k me seli Ferizaj me datën 27 janar 2023 ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, deklarimeve të palëve se pajtohen me mendimin e ekspertit shqyrtues për rivlerësim të aktivitetit të prokurimit, paneli shqyrtues deklaron se procedura e shqyrtimit të ankesës përfundon në këtë fazë, ndërkaq obligohet Autoriteti Kontraktues Komuna Ferizaj, që aktivitetin e prokurimit ta rivlerësoj sipas mendimit të ekspertit shqyrtues, dhe brenda afatit 10 ditor konform LPP-së ta njoftoj panelin shqyrtues me veprimet e ndërmarra.

Paneli Shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryetar i PSH-së
Agon Ramadani

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Komuna Ferizaj
1x1 OE"Krosa Traffic Signs" sh.p.k me seli Ferizaj
1x1 Arkivës së OSHP-së;
1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.